

124/2
20.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E DERREGULLIMIT, LEJEVE DHE LICENCAVE

Nr. 3079 / Prot.

Tiranë, më 19.7. 2022

Lënda: Dërgohet draft-raporti i grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse, për pranimet në programet e studimit, sipas kapaciteteve të deklaruara nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, për vitin akademik 2022-2023.

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan

Bashkëlidhur ju dërgojmë raportin e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga institucioni juaj, për vitin akademik 2022 - 2023.

Sa më sipër, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij drafti, duhet të plotësoni rekomandimet e lëna në draft raport, me qëllim vijimin e certifikimit të kuotave nga ana e MAS, sipas kalendarit të miratuar për pranimet e studentëve në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI



-DKSBC
-DBN/PA
për informuesit
ose direktorin
përfundim
20.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3079 / Prot. 156

Tiranë, më 19.7. 2022

Lënda: Draft raport mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan për vitin akademik 2022-2023.

Z. ALQI KUSHI

Sekretar i përgjithshëm, MAS

Tiranë

Mbështetur në Urdhrin Nr. 232, datë 29.04.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për “Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë, për vitin akademik 2022-2023”, grupi i punës kreu verifikimet pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, sipas objektit dhe metodologjisë si më poshtë:

OBJEKTI


Verifikimi i kapaciteteve pritëse akademike dhe infrastrukturore për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara.

METODOLOGJIA

- Takim me drejtues të Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;
- Verifikimi i kapaciteteve infrastrukturore;
- Shqyrtimi i dokumentacionit të stafit akademik.

GRUPI I PUNËS

- a) Rozeta Hoxha
- b) Erjon Ndroqi
- c) Suada Hawa
- d) Elda Liksala



GJETJE DHE KONSTATIME

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan është institucion publik i arsimit të lartë dhe përbëhet nga 5 Njësi Kryesore si më poshtë:

- Fakulteti i Shkencave Humane, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë (4 Departamente dhe Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike), ofron 23 programe studimi nga të cilët 12 Bachelor, 3 Master Profesional, 5 Master i Shkencave, 3 programe me karakter profesional.
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë, ofron 15 programe studimi nga të cilët 6 Bachelor, 3 Master Profesional, 2 Master i Shkencave dhe 4 programe studimi me karakter profesional.
- Fakulteti Ekonomik, i cili përbëhet 6 njësi bazë, (5 Departamente dhe Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi), ofron 19 programe studimi nga të cilët 6 Bachelor, 6 Master Profesional, 6 Master i Shkencave, 1 PIND në Drejtësi.
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë (4 Departamente dhe Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin në Edukim), ofron 28 programe studimi nga të cilët 7 Bachelor, 17 Master Profesional, 3 Master i Shkencave dhe 1 program studimi me karakter profesional.
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, i cili përbëhet nga 4 njësi bazë ku ofrohen 14 programe studimi nga të cilët 6 Bachelor, 6 Master Profesional dhe 2 Master i Shkencave.

I- KAPACITETET AKADEMIKE TË INSTITUCIONIT

Për vitin akademik 2022-2023, Institucioni ka deklaruar kapacitetet akademike për secilin Departament sipas Fakulteteve, si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Humane, ka në strukturën e tij gjithsej 95 pedagogë nga të cilët 55 personel akademik me kohë të plotë, 40 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 4 departamente dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike. Raporti staf efektiv/joefektiv është në bazë fakulteti 58% me 42%.

- Departamenti i Gjuhësisë, ka në strukturën e tij 16 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me grada dhe tituj dhe 9 personel akademik me kohë të pjesshme, 6 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 44% me 56%.
- Departamenti i Histori-Gjeografisë, ka në strukturën e tij 11 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me grada dhe tituj dhe 4 personelit akademik me kohë të pjesshme, 3 me grada dhe tituj. Raporti staf efektiv/joefektiv është 54% me 46%.
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja, ka në strukturën e tij 45 pedagogë nga të cilët 23 personel akademik me kohë të plotë, 20 me tituj dhe grada dhe 22 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 51% me 49%.



- Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, ka në strukturën e tij 16 pedagogë nga të cilët 11 personel akademik me kohë të plotë, 8 me grada dhe tituj dhe 5 personelit akademik me kohë të pjesshme, 3 me grada dhe tituj. Raporti staf efektiv/joefektiv është 69% me 31%.
- Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike ka në përbërje 7 personel akademik nga të cilët 6 me tituj e grada, të gjithë me angazhim me kohë të plotë.

Referuar numrit të pritshëm të studentëve në këtë fakultet për vitin 2022-2023 (453 studentë vijues + 541 kuota të reja) 994 studentë, raporti i pritshëm pedagogë efektiv/studentë është 1/18, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, Aneksi 1/A.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka në strukturën e tij gjithsej 110 pedagogë nga të cilët, 36 personel akademik me kohë të plotë dhe 74 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 5 departamente dhe Qendrën e Zhvillimit Mjedisor. Raporti staf efektiv/joefektiv në bazë fakulteti është 67% / 33%.

- Departamenti i Biologjisë, ka në strukturën e tij 21 pedagogë nga të cilët 8 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me grada dhe tituj, dhe 13 personel akademik me kohë të pjesshme nga të cilët 6 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 38% me 62%.
- Departamenti i Matematikës, ka në strukturën e tij 21 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 6 me tituj dhe grada dhe 14 personel akademik me kohë të pjesshme 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 33% me 67%.
- Departamenti i Fizikës, ka në strukturën e tij, 11 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 5 me tituj dhe grada dhe 4 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 64% me 36%.
- Departamenti i Kimisë, ka në strukturën e tij 18 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 6 me tituj dhe grada, dhe 11 personel akademik me kohë të pjesshme, 5 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 39% me 61%.
- Departamenti i Informatikës, ka në strukturën e tij, 39 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 4 me tituj dhe grada dhe 32 personel akademik me kohë të pjesshme, 5 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 18% me 82%.

Referuar numrit të pritshëm të studentëve në këtë fakultet për vitin 2022-2023 (511 studentë vijues + 671 kuota të reja) 1182 studentë, raporti i pritshëm pedagogë efektiv/studentë është 1/33, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, Aneksi 1/A.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, ka në strukturën e tij gjithsej 95 personel akademik, 38 me kohë të plotë, si dhe 57 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 5 departamente dhe Qendrën për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim. Raporti staf efektiv/joefektiv, në bazë fakulteti është 40% / 60%.

- Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar ka në strukturën e tij 15 pedagogë, nga të cilët 8 me kohë të plotë, nga të cilët 7 me tituj dhe grada dhe 7 personel akademik me kohë të pjesshme. Raporti staf efektiv/joefektiv është 53%/37%.
- Departamenti i Psikologjisë, ka në strukturën e tij 21 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada, 14 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 33% me 67%.
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka në strukturën e tij 25 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada, 14 personel akademik me kohë të pjesshme, 10 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 12% me 88%.
- Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies, ka në strukturën e tij 27 pedagogë nga të cilët 9 personel akademik me kohë të plotë, 8 me tituj dhe grada, 18 personel akademik me kohë të pjesshme, 10 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 38% me 62%.
- Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin në Edukim, ka në strukturën e tij 7 pedagogë, të gjithë me kohë të plotë me tituj dhe grada.

Referuar numrit të pritshëm të studentëve në këtë fakultet për vitin 2022-2023 (788 studentë vijues + 1105 kuota të reja) 1893 studentë, raporti i pritshëm pedagogë efektiv/studentë është 1/50, kjo jo në përputhje me parashikimet e VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, Aneksi I/A, ku parashikohet se ky raport duhet të jetë 1 pedagog për 45 studentë.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, ka në strukturën e tij gjithsej 170 pedagogë nga të cilët, 40 personel akademik me kohë të plotë dhe 130 personel akademik me kohë të pjesshme të shpërndarë në 4 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv, në bazë fakulteti është 24% me 76%.

- Departamenti i Infermieristikës, ka në strukturën e tij 70 pedagogë, nga të cilët 11 personel akademik me kohë të plotë, 4 me tituj dhe grada, 59 personel akademik me kohë të pjesshme, 5 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 16% me 84%.
- Departamenti i Lëndëve Paraklinike, ka në strukturën e tij 30 pedagogë, nga të cilët 10 personel akademik me kohë të plotë, 5 me tituj dhe grada, 30 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 33% me 67%.
- Departamenti i Lëndëve Klinike ka në strukturën e tij 42 pedagogë, nga të cilët 12 personel akademik me kohë të plotë, 5 me tituj dhe grada, 30 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 29% me 71%.
- Departamenti i Specialiteteve teknike Mjekësore, ka në strukturën e tij 28 pedagogë nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 3 me tituj dhe grada, 21 personel akademik me kohë të pjesshme, 3 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv 25% me 75%.

Referuar numrit të pritshëm të studentëve në këtë fakultet për vitin 2022-2023 (1803/1043¹ studentë vijues + 1291 kuota të reja) 3094 studentë në total, raporti i pritshëm pedagogë efektiv/studentë

¹ Sipas sqarimeve të IAL, në përbërjen e numrit total të studentëve vijues në këtë fakultet janë 350 studentë jo aktiv, pasi janë mbetës të vetëm një provimi, si dhe 410 studentë janë frekuentues vetëm të praktikës spitalore dhe e kryejnë shërbimin në Qendrën Spitalore Xh. Kongoli. Kjo do të thotë që numri i studentëve vijues faktikisht, për vitin 2022-2023 është 1043.

është 1/77, duke pasur parasysh faktin që 60 pedagogët e jashtëm të këtij fakulteti janë pjesë e strukturës spitalore², të angazhuar në procesin akademik për pjesën e praktikës dhe laboratorëve ky raport është, 1/31 pra nuk është në kundërshtim me parashikimet e VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, Aneksi 1/A.

Fakulteti Ekonomik, ka gjithsej 115 pedagogë, nga të cilët 44 personel akademik me kohë të plotë dhe 71 personel akademik me kohë të pjesshme, të shpërndarë në 5 departamente. Raporti staf efektiv/joefektiv 38% me 62%.

- Departamenti i Administrim Biznesit, ka në strukturën e tij 20 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada dhe 13 personel akademik me kohë të pjesshme, 4 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 35% me 65%.
- Departamenti i Financë Kontabilitetit, ka në strukturën e tij 28 pedagogë, nga të cilët 9 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada, 19 personel akademik me kohë të pjesshme, 5 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 32% me 68%.
- Departamenti i së Drejtës, ka në strukturën e tij 20 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, 6 me tituj dhe grada, 13 personel akademik me kohë të pjesshme, 11 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 35% me 65%.
- Departamenti i Ekonomiksit, ka në strukturën e tij 10 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada dhe 3 personel akademik me kohë të pjesshme, të gjithë me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 70% me 30%.
- Departamenti i Marketingut dhe Inxhinierisë, ka në strukturën e tij 30 pedagogë, nga të cilët 7 personel akademik me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada, 23 personel akademik me kohë të pjesshme, 9 me tituj dhe grada. Raporti staf efektiv/joefektiv është 23% me 77%.
- Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi ka në strukturë 7 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 4 me tituj dhe grada.

Referuar numrit të prishëm të studentëve në këtë fakultet për vitin 2021-2022 (1070 studentë vijues + 1150 kuota të reja) 2220 studentë, raporti i prishëm pedagogë efektiv/studentë është 1/50, jo përputhje me parashikimet e VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, Aneksi 1/A, ku parashikohet se ky raport duhet të jetë 1 pedagog për 45 studentë.

II- KAPACITETET FIZIKE INFRASTRUKTURE

Universiteti i Elbasanit ushtron aktivitetin e vetë në 12 godina universitare si më poshtë:

- Rektorati
- Korpusi kryesor (Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe i Shkencave Humane)
- Shtëpia e Pritjes
- Biblioteka Universitare

² Sipas dy marrëveshjeve të bashkëpunimit, mes Spitalit Psikiatrik “Dr. Sadik Dinci” Elbasan dhe Universitetit A. Xhuvani datë 30.05.2022 dhe Qendrës Spitalore “Dr. Xh. Kongoli”.

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina A)
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina B)
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina C)
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina e ish-Matërnitetit)
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Spitali i Psikiatrisë me kontratë)
- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- Laboratori i Metalurgjisë (Fakulteti i Shkencave të Natyrës)
- Palestra Nr.1
- Palestra Nr.2

Rektorati është një godinë në pronësi të MASR, me katër kate dhe sipërfaqe 924 m². Gjithashtu në këtë godinë ndodhen dhe 3 zyra për stafin akademik.

Korpusi kryesor është një godinë ku zhvillojnë veprimtarinë dy fakultete, përkatësisht Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Fakulteti i Shkencave Humane, është në pronësi të MAS. Ky korpus është më katër kate dhe ka një sipërfaqe prej 9669 m². Nga kjo sipërfaqe, 3403 m² i përkasin sallave dhe laboratorëve mësimdhënës, ku numri i laboratorëve është 29 me kapacitet 925 vende. Numri i klasave për seminare është 14 me kapacitet 550 vende. Numri i auditorëve (klasa për leksione) është 17 me kapacitet 1460 vende.

Shtëpia e pritjes është një godinë me tre kate në pronësi të MAS, me një sipërfaqe 634 m². Nga kjo sipërfaqe 81 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënës. Kjo godinë ka vetëm një auditor me kapacitet 40 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 1 zyrë për stafin akademik.

Biblioteka Universitare është një godinë me tre kate në pronësi të MAS, me një sipërfaqe 1466 m². Nga kjo sipërfaqe 972 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënës. Në këtë bibliotekë numri i titujve të teksteve/librave është 22200 dhe numri i vendeve për lexues është 309.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina A), është një godinë me tre kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 1382 m². Nga kjo sipërfaqe 845 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënës. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 2 me kapacitet 105 vende, numri i klasave për seminare është 12 me kapacitet 443 vende dhe numri i auditorëve (klasa për leksione) është 3, me kapacitet 420 vende dhe 4 zyra për stafin akademik.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina B), është një godinë me dy kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 360 m². Nga kjo sipërfaqe 248 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënës. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 1 me kapacitet 20 vende, numri i auditorëve (klasa për leksione) është 2, me kapacitet 240 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 3 zyra për stafin akademik.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (Godina C), është një godinë me tre kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 1208 m². Nga kjo sipërfaqe 783 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënës. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 3 me kapacitet 140 vende, numri i

auditorëve (klasa për leksione) është 5, me kapacitet 420 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 5 zyra për stafin akademik. Numri i titujve në Bibliotekë është 1000 dhe numri i vendeve për lexues 35.

Godina e ish-Maternitetit, është një godinë me 1-4 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 1313 m². Nga kjo sipërfaqe 450 m², shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 1 me kapacitet 20 vende. Në këtë godinë ka dhe 3 zyra për stafin akademik. Numri i klasave për seminare është 1 me kapacitet 40 vende.

Fakulteti Ekonomik është një godinë 2-4 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 2706 m². Nga kjo sipërfaqe 1865 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 4 me kapacitet 120 vende, numri i klasave për seminare është 7 me kapacitet 360 vende, numri i auditorëve (klasa për leksione) është 11, me kapacitet 1090 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 16 zyra për stafin akademik. Ky fakultet ka një bibliotekë me 1000 tituj tekste/libra me 35 vende leximi.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit është një godinë 3-4 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 2508 m². Nga kjo sipërfaqe 1709 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 6 me kapacitet 245 vende, numri i klasave për seminare është 11 me kapacitet 520 vende, numri i auditorëve (klasa për leksione) është 11, me kapacitet 1190 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe nëntë zyra për stafin akademik. Ky fakultet ka një bibliotekë me 800 tituj tekste/libra me 20 vende leximi.

Laboratori Metalurgji (Fakulteti i Shkencave të Natyrës), është një godinë 1-2 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 1739 m². Nga kjo sipërfaqe 1180 m² shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 7 me kapacitet 140 vende, numri i auditorëve (klasa për leksione) është 1, me kapacitet 85 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 10 zyra për stafin akademik.

Palestra Nr.1 është një godinë 1 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 418 m². Nga kjo sipërfaqe 374 m² shërbejnë si salla mësimdhënie, ku numri i sallave është 2 me kapacitet 60 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 2 zyra për stafin akademik.

Palestra Nr.2 është një godinë 2 kate në pronësi të MAS dhe ka një sipërfaqe prej 1000 m². Nga kjo sipërfaqe 105 m² shërbejnë si salla mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 3 me kapacitet 200 vende, numri i klasave për seminare është 3, me kapacitet 150 vende dhe numri i auditorëve (klasa për leksione) është 1 me kapacitet 70 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 70 zyra për stafin akademik.

Me kontratë nr.1159 prot., datë 06.05.2022 të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", dhe nr.330 prot., datë 30.05.2022 të Spitalit Psikiatrik, IAL ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionet e kujdesit shëndetësor në varësi të spitalit, si dhe vënien në dispozicion të ambienteve për realizimin e këtij qëllimi. Sipas deklarimeve të IAL sipërfaqja prej 4150 m² pjesë e spitalit do të shërbejnë si salla dhe laboratorë mësimdhënie. Në këtë godinë numri i laboratorëve është 6 me kapacitet 245 vende. Numri i klasave për seminare është 2 me kapacitet 60 vende. Gjithashtu në këtë godinë ka dhe 5 zyra për stafin akademik.



Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, sipërfaqja në total është 32’818 m² nga e cila 24’464 m² janë ambiente në funksion të aktivitetit akademik dhe nga kjo sipërfaqe 16’644 m² janë salla mësimdhënie/laboratorë dhe palestra).

Për godinat e mësipërme institucioni disponon akt higjieno-sanitare të vitit 2014 dhe aktin teknik të mbrojtjes nga zjarri të vitit 2016.

Procesi mësimor në këtë institucion është i organizuar sipas fashave orare të përdorimit të mjediseve të institucionit, ku një pjesë e studentëve zhvillojnë mësimin paradite dhe një pjesë pasdite e në fundjavë, duke mos përdorur njëkohësisht mjediset e IAL.

Në total Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan ka një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 24’464 m² (në këtë sipërfaqe nuk është llogaritur magazina, si dhe sipërfaqja e spitalit të psikiatrisë e deklaruar nga IAL, si dhe në sipërfaqen e godinës së ish maternitetit është llogaritur vetëm sipërfaqja prej 450 m²) në mjediset e mësipërme, sipas deklarimit të institucionit për vitin akademik 2022-2023 do të ndjekin studimet 9383 studentë, 4625 studentë të rinj dhe 4758 studentë vijues.

III- PARASHIKIMI PËR KAPACITETET PRITËSE PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, me Vendim Senati Nr.9 datë 10.03.2022 dhe Nr.10 datë 12.03.2022 dhe Vendim të Bordit të Administrimit Nr.15 datë 12.03.2022 dhe Nr.16 datë 12.03.2022, ka miratuar kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023, në 37 programe studimi të ciklit të parë Bachelor, 1 program i integruar i ciklit të dytë “Drejtësi”, 35 programe studimi ciklit të dytë Master Profesional, 18 programe Master i Shkencave, 8 programe me karakter profesional.

Për vitin akademik 2022-2023 numri i kuotave të miratuara nga Senati Akademik është 4758. Kuotat e deklaruara nga IAL janë si më poshtë:

- Kuota për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Humane	541
- Kuota për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës	671
- Kuota për programet e studimit në Fakultetin Ekonomik	1150
- Kuota për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit	1105
- Kuota për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike	1291

Referuar numrit aktual të studentëve pa vitin e fundit, kuotave të reja të pranimit për të gjitha ciklet e studimit, 9383 studentë në total (4758 kuota të reja + 4625 studentë vijues) kapaciteteve dhe infrastrukturës së godinave, (24’464 m²), fushave të programeve të studimit, dhe organizimit të mësimit në dy fasha orare, për vitin akademik 2022-2023, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan ka një raport prej 5.2 m²/student, për të gjitha fakultetet.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit në Spitalin e Psikiatrisë, për programet e studimit në fushën e shkencave mjekësore teknike, në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale për këto programe ofrohet dhe 4150 m² të cilat nuk janë të llogaritura në raport.

Sa më sipër, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat

Page 8

për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre” Aneksi 1/C, normativat për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit janë 2.5 m² për studentët që ndjekin programe studimi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Humane, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Fakultetin Ekonomik dhe 5 m²/student për studentët që ndjekin programe studimi në Fakultetin e Shkencave Teknike Mjekësore.

KONKLUZIONE

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan plotëson kërkesën ligjore të përcaktuar në pikën 4 të nenit 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ku cilësohet “*Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik...*”.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 “*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*”, Aneksi 1/A, për FSHN, FHF, FSHH.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, nuk plotëson kriteret të përcaktuara në Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.05.2017 “*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*”, Aneksi 1/A, për FSHE dhe FE.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan plotëson kriteret minimale infrastrukturore të përcaktuara në VKM nr. 418, datë 10.05.2017 “*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*” Aneksi 1/C, normativa për sipërfaqe të shfrytëzueshme sipas fushave të studimit është minimumi 2.5 m² për studentët që ndjekin programe studimi në fushën e shkencave shoqërore dhe humane dhe 5 m² për studentët që ndjekin programe studimi në fushën e Shkencave Mjekësore.

REKOMANDIME

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan të marr masa përmbushjen e parashikimeve të VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*”, Aneksi 1/A, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, duke rekrutuar të paktën 4 pedagogë efektiv para fillimit të vitit akademik 2022-2023 ose duke reduktuar me 183 numrin e kuotave të parashikuara për vitin akademik 2022-2023 për programet e ofruara nga kjo njësi kryesore.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan të marr masa përmbushjen e parashikimeve të VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve te Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*”, Aneksi 1/A, në Fakultetin Ekonomik, duke rekrutuar të paktën 5 pedagogë efektiv para fillimit të vitit akademik

2022-2023 ose duke reduktuar me 240 numrin e kuotave të parashikuara për vitin akademik 2022-2023 për programet e ofruara nga kjo njësi kryesore.


Kuotat e miratuara me vendim të institucionit të arsimit të lartë, janë paraqitur në tabelë në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij raporti.

GRUPI I PUNËS

Rozeta Hoxha



Erjon Ndroqi



Suada Hawa



Elda Liksala

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XIHUVANI" ELBASAN

FAKULTETI	PROGRAM_STUDIMI	TOTAL KUÇTA 2022-2023	SHQIPËTARË BRENDA VENDIT	Që aplikojnë për program II	Që aplikojnë për Transferim studimesh	Të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi të kufizuar	Romë + balkano egiptian	Kosovë	Maqedoni	Mal i Zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë	Total troje	
CHIKLI PARE Fakulteti i Shkencave Humane	Gjuhë shqipe dhe letërsi	30	25	2	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2	
	Gjuhë shqipe dhe frënge	15	15	2	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2	
	Histori - Gjeografi	25	20	2	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2	
	Histori dhe Gjuhë Gjermane	15	15														
	Gjeografi dhe Gjuhë Italiene	15	15														
	Gjuhë angleze	60	50	3	3	0	1	1	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Gjuhë gjermane	17	15	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Gjuhë frënge	17	15	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Gjuhë italiane	17	15	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Gazetari	40	38	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Gazetari dhe gjuhë angleze	40	38	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Gjuhë shqipe dhe rome	15	12	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	
	Fakulteti i Shkencave te Natyres	Biologji – Kimi	35	30	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Matematikë – Fizikë	36	30	3	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Teknologjitë e informacionit	96	90	3	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Matematikë - Informatikë	25	25	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fizikë - Komputertike		15	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Studime Mjedisore		41	35	1	4	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Fakulteti Ekonomik	Administrim – Biznesi, profili Specialist Marketingu	92	80	2	5	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Financë – Konabilitet	92	80	2	5	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Ekonomia dhe e drejta	92	80	2	5	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Informatikë ekonomike	92	80	2	5	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Ekonomi turizmi	52	50	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Administrim biznesi dhe inzhinieri	52	50	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI	50	40	4	4	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2	
	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	50	40	4	4	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	2	
	Edukim gjyetar	15	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Punonjës Social	60	50	3	3	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	2	
	Psikologji	40	35	1	2	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	
	Filozofi-Sociologji	15	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Edukim fizik dhe sporte	121	90	6	5	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	12	
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Infermieri e Përgjithshme	285	250	25	5	0	0	2	2	1	0	0	0	0	0	1	
	Infermieri Manni	180	160	10	5	0	0	1	2	2	0	0	0	0	0	2	
	Logopedi	40	40	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	Fizioterapi	104	100	2	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	
Fakulteti i Shkencave humane	Teknik laborator	105	100	2	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	1	
	Imazheri	105	100	2	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	1	
	M.P Redaktim	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
CHIKLI I DYTE	M.P Gazetar reporter	15	14	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	
	M.P Gazetari sportive	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	M.SH Gjuhësi	16	10	4	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	2	

Handwritten signatures and initials in blue ink, including a large signature on the left and several smaller ones on the right.

	M.P. Fizioterapi	40	40	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.P. Teknik Imazherie	40	40	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.P. Infermieri kirurgjike	31	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.P. Logopedi	35	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.P. Teknik Laboratori	51	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.SH Infermieri	173	150	15	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	M.SH Mami	50	40	5	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PROGRAMI PROFESIONAL 2 VJEÇAR																								
Fakulteti i Shkencave Humane																								
	Sekretarë të specializuar dhe administrativë	45	40	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Operator Turistik në Gjithë Gjermane	50	47	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Operator Turistik	49	47	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Shkencave të Natyrës																								
	Teknologji Laboratori	83	80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Mekatronikë	70	68	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Logjistikë	60	58	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Teknik Mjedisi	90	88	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Shkencave të Edukimit																								
	Edukatore për fëmijët (0 - 3 vjeç)	80	77	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PIND																								
Fakulteti Ekonomik																								
	Drejtesi	146	115	20	5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2



